“Shikoni ata që janë poshtë jush e mos i shikoni ata që janë sipër jush, sepse kështu ka më pak gjasa që të mos i përçmoni begatitë e Allahut ndaj jush.”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Shikoni ata që janë poshtë jush e mos i shikoni ata që janë sipër jush, sepse kështu ka më pak gjasa që të mos i përçmoni begatitë e Allahut ndaj jush.”
[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti në këtë hadith e urdhëroi muslimanin që, në çështjet e kësaj bote, t'i shikojë ata që janë më poshtë tij dhe më pak se ai për nga gjendja, pasuria, pozita e nderi, e të mos shikojë ata që janë mbi të apo më të përparuar se ai. Kjo sepse shikimi te ata që janë më poshtë njeriut, ka më pak gjasa që të mos nënvlerësohen dhe përbuzen begatitë që Allahu ti ka dhuruar.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/5341